



**INSPEKTORATI I LARTË**

**TRANSPARENCY INTERNATIONAL**

**I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT**

**ALBANIA**

**TË PASURIVE**

Nr. 1171 Prot.

Nr. 242/6 Prot

### **MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

**NDËRMJET**

**Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, (referuar si ILDKP) i cili është Autoriteti kompetent për qëllimin e kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi,**

**DHE**

**Transparency International Albania, (referuar si TIA) i cili është Autoriteti kompetent për qëllimin e kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi,**

ILDKP dhe TIA (këtej e tutje të quajtura Palët),

*Të vetëdijshme për rëndësinë e realizimit të transparencës në forcimin e rolit të publikut në mirëqeverisje.*

*Me dëshirën e mirë për të bashkërenduar veprimtarinë në luftën kundër korrupsionit.*

*Duke riafirmuar vendosmërinë për hartimin e masave konkrete të bashkëpunimit midis institucioneve publike dhe shoqërisë civile, palët,*

*Bien dakord për sa më poshtë:*

## **Neni 1**

### **Qëllimi**

Shkëmbimi i informacionit brenda objektit të veprimtarisë së palëve dhe bashkëpunimi reciprok ndërmjet institucioneve publike dhe shoqërisë civile në luftën kundër korrupsionit.

## **Neni 2**

### **Angazhimi i palëve**

- 2.1 ILDKP angazhohet të shqyrtojë çdo informacion të referuar nga TIA, brenda juridiksionit dhe kompetencave të tij.
- 2.2 ILDKP angazhohet në krijimin e hapësirave të nevojshme për përmbushjen dhe realizimin e transparencës në përputhje me objektin e kësaj marrëveshjeje.
- 2.3 TIA merr përsipër të referojë pranë ILDKP informacionin dhe ankesat e depozituara pranë saj të cilat lidhen ngushtësisht me objektin e veprimtarisë së Inspektoratit të Lartë.
- 2.4 TIA merr përsipër të ofrojë kontributin e saj në forcimin e mekanizmave ligjore të ILDKP në luftën kundër korrupsionit dhe të informojë periodikisht ILDKP mbi indeksin e korrupsionit në rradhët e administratës publike.

## **Neni 4**

### **Koordinimi ndërmjet palëve**

- 4.1 Palët do të caktojnë një person kontakti që do të jetë përgjegjës për zbatimin konkret të Marrëveshjes së Bashkëpunimit.
- 4.2 Komunikimi ndërmjet palëve do të jetë në formë shkresore.

## Neni 5

### Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

- 5.1 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar.
- 5.2 Amendamentet mund të bëhen me marrëveshje nga Palët nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim, duke saktësuar datën e hyrjes në fuqi.
- 5.3 Çdo mosmarrëveshje krijuar mbi interpretimin ose ekzekutimin e këtij Marrëveshje do të zgjidhet me marrëveshje dypalëshe.
- 5.4 Përveç parashikimit të paragrafit 1 të këtij neni, kjo Marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë nga secila palë, duke njoftuar paraprakisht 60 ditë para me shkrim, palën tjetër.
- 5.5 Marrëveshja hartohet në gjuhën shqipe, përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, 2 (dy) prej të cilave depozitohen në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe 2 (dy) të tjera në Transparency International Albania.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi u nënshkrua sot, më datë 19.03.2010.

**PËR INSPEKTORATIN E LARTË TË  
DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT  
TË PASURIVE**

**INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM**

*Adriatik LLALLA*  
**Adriatik LLALLA**



**PËR TRANSPARENCY  
INTERNATIONAL ALBANIA**

**DREJTOR EKZEKUTIV**

*Lutfi Dervishi*  
**Lutfi DERVISHI**

